



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 22.01.2020

PËR

**MIRATIMIN E LICENCIMIT TË ZJ. ARJETA SHEHU, PËR TË USHTRUAR
VEPRIMTARI BROKERIMI NË TITUJ, SI BROKER FIZIK, NË EMËR DHE PËR
LLOGARI TË SHOQËRISË “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 61, të Ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe të Rregullores nr. 165, datë 23.12.2008 “Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarëve të investimeve”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e zj. Arjeta Shehu, për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj, si broker fizik, në emër dhe për llogari të shoqërisë “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI